



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 733 Akti**

**Nr. 766 Vendimi**  
**Tiranë, më 22.5.2024**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	Kryesuese
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datat 27.3.2024 dhe 21.5.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ervin Aliu**, me detyrë ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Alma Faskaj, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2021 zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjyquese, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Alma Faskaj.

3. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.6.2021 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

5. Në bazë të pikës 2 të vendimit nr. 3, datë 8.1.2020, të Komisionit “Për dhënien e aksesit në dosjet e arkivuara trupave gjyquese që shqyrtojnë subjektet e rivlerësimit me lidhje familjare midis tyre”<sup>1</sup>, u administrua dokumentacioni i dosjes së hetimit të subjektit R.A (P), bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, i cili u konsiderua prova që lidhet me procesin e rivlerësimit të subjektit Ervin Aliu<sup>2</sup>. Komisioni vlerëson të theksojë faktin se procesi i rivlerësimit i subjektit Ervin Aliu është një proces i pandarë nga ai i bashkëshortes së tij, znj. R.A (P), subjekt rivlerësimi.

6. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ILDKPKI-ja dërgoi aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu ka arritur në konkluzionin se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit

<sup>1</sup> Vendimi nr. 2, datë 6.12.2023, i trupit gjykues për administrimin e dokumentacionit të dosjes hetimore të subjektit të rivlerësimit R.A (P).

<sup>2</sup> Nga faqja zyrtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton se ndaj subjektit R.A (P) është marrë vendimi nr. 372, datë 22.4.2021, i cili ka marrë formë të prerë në datën 7.6.2021.

ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar raportin<sup>3</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu.

**8.** KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, në mbështetje të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**9.** Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

**10.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 7.3.2024, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**11.** Subjekti i rivlerësimit në datën 7.3.2024 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

**12.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datën 21.3.2024.

**13.** Në datën 25.3.2024, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**14.** Subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht, me *email*, në datën 25.3.2024.

**15.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.3.2024, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

**16.** Pas zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 27.3.2024, me vendimin nr. 5, datë 28.3.2024, trupi gjykues vendosi të rihapë hetimin gjyqësor me qëllim që të hetohet lidhur me adresat e banimit të deklaruara nga subjekti dhe bashkëshortja e tij dhe vuri në dijeni subjektin në lidhje me këtë vendimmarrje.

---

<sup>3</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2023, të KDZH-së.

17. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në mbledhjen e tij në datën 9.5.2024<sup>4</sup>, pasi u njoh me rezultatet e hetimit shtesë, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ pas riçeljes së hetimit; (iii) njoftimin e subjektit për t'u njohur me provat e reja të administruara nga Komisioni, si dhe për të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, marrjen e provave, afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta, si dhe të parashtrijë objeksionet e tij.

18. Pas marrjes së shpjegimeve me shkrim mbi rezultatet e hetimit shtesë dhe provave bashkëlidhur, trupi gjykues, me vendimin nr. 7, datë 17.5.2024, "Për kalimin në seancë dëgjimore të subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu", vendosi ta ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 21.5.2024, në orën 10:00.

19. Në datën 21.5.2024, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore e radhës pas riçeljes së hetimit administrativ.

20. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu kërkoi nga Komisioni konfirmimin e tij në detyrë.

### III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

22. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

23. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23.1 Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>5</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezultojnë se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

<sup>4</sup> Në referim të vendimit nr. 5, datë 28.03.2024.

<sup>5</sup> "41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi". Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: "Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë". Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse".

**23.2** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkrese të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) dokumentacionin e dosjes së hetimit të subjektit R.A (P), bashkëshorte e subjektit të rivlerësimit; (dh) provat shkrese/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuara pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (ë) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (f) denoncimet e publikut; (g) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**24.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**24.1** Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 31.7.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri dhe likuiditete:

**25. Automjet tip “Mercedes-Benz”, C Class 220 CDI**, me targë \*\*\*, prodhim i vitit 2001, blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.4.2016. Vlera: 4,000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat e siguruara nga kredia bankare, datë 23.3.2016, nga “Raiffeisen Bank”, blerësit Ervin R. Aliu dhe R.H.A. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me bashkëshorten 1/2 pjesë.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**25.1** Nga hetimi rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.4.2016, subjekti Ervin Aliu dhe bashkëshortja R.A kanë blerë automjetin e sipërcituar nga shitësi M.D, në vlerën 4,000 euro. Sipas kësaj kontrate, pala blerëse deklaroi se shumën 4,000 euro e ka marrë njëkohësisht kur ka bërë edhe dorëzimin e mjetit. Sipas certifikatës së pronësisë së mjetit rrugor rezultoi se automjeti është regjistruar në emrin e shtetasve Ervin dhe R.A<sup>6</sup>.

**25.2** DPSHTRR-ja<sup>7</sup> konfirmoi regjistrimin e automjetit me targë \*\*\*, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.4.2016, në vlerën 4,000 euro nga shtetasja M.D, e cila kishte paguar doganën në datën 14.4.2016. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit për shitësin e automjetit<sup>8</sup>, ku nuk rezultuan problematika.

### **Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë**

**25.3** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ky mjet është blerë me të ardhurat e siguruara nga kredia bankare, datë 23.3.2016, nga Raiffeisen Bank.

<sup>6</sup> Aneksi 4/2 i dosjes së ILDKPKI-së.

<sup>7</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2021.

<sup>8</sup> Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**25.4** Kjo pasuri është deklaruar në DIPP-në e vitit 2016, me të njëjtin burim krijimi të deklaruar edhe në deklaratën *Vetting: me të ardhurat e siguruara nga kredia bankare e datës 23.3.2016*.

**25.5** Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, në rubrikën “Detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar se ka marrë kredinë në shumën 1,200,000 lekë, në datën 23.3.2016, për arsye personale (shlyerje të kredive të mëparshme, blerje automjeti dhe pagesë paketë turistike në gusht 2016). Kjo kredi është deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2017, duke përcaktuar shumat e detyrimit të shlyer dhe atij të mbetur.

**25.6** Me anë të kontratës së kredisë bankare të datës 23.3.2016, subjektet Ervin dhe R.A kanë marrë nga Raiffeisen Bank një kredi në shumën 1,200,000 lekë, me qëllim përdorimin për arsye personale, disbursuar në datën 25.3.2016, me afat 36 mujor.

**25.7** Nga lëvizjet e llogarisë së Raiffeisen Bank<sup>9</sup> rezultojnë se shuma 1,200,000 lekë është disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 25.3.2016 dhe në të njëjtën datë janë mbyllur dy kredi të mëparshme në këtë bankë, duke u paguar shuma në total prej 452,853.35 lekësh. Ndërsa, shuma e mbetur prej 700,736 lekësh është tërhequr *cash* në datën 26 deri më 29.3.2016. Kjo shumë e tërhequr e mbulon tërësisht vlerën 4,000 euro të automjetit të paguar në datën 16.4.2016.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**25.8** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit dhe deklarimeve të subjektit në seancë dëgjimore çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**26. Automjet tip “Mercedes-Benz” C Class 180, me targë \*\*\***, prodhim i vitit 1993, blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2016. Vlera: 140,000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat e siguruara nga paga. Blerës: Ervin Aliu. Pjesa në përqindje: në bashkëpronësi me bashkëshorten 1/2 pjesë.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**26.1** Nga hetimi rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2016<sup>10</sup>, subjekti Ervin Aliu ka blerë automjetin nga shitësi G.J.P.T në vlerën 140,000 lekë. Sipas kësaj kontrate, shuma e blerjes së automjetit do të likuidohet nëpërmjet bankës në llogarinë e shitësit. Sipas certifikatës së pronësisë së mjetit rrugor, automjeti me targë \*\*\* është i regjistruar në emër të shtetasit Ervin R. Aliu<sup>11</sup>.

**26.2** Për sa i takon pagesës së çmimit të blerjes së kësaj pasurie, nga lëvizjet e llogarisë bankare të subjektit Ervin Aliu në “Raiffeisen Bank” rezultoi se në datën 21.10.2016, 10 ditë pas redaktimit të kontratës së shitjes, është transferuar shuma 140,300 lekë, me përshkrimin “Pagesë për blerje automjeti...”, me përfituese M.D.

**26.3** Për këtë shtetase (M.D) rezultoi se është pyetur subjekti R.A (bashkëshortja e subjektit) gjatë procesit të rivlerësimit<sup>12</sup> mbi raportet me këtë shtetase dhe arsyet e kalimit të çmimit të blerjes në llogari të saj, ku subjekti R.A ka sqaruar se shtetasja M.D është bashkëshortja e shitësit të automjetit, z. G.J.T. Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti R.A gjatë procesit të

<sup>9</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021, nga Raiffeisen Bank.

<sup>10</sup> Aneks 4/3, dosja ILDKPKI.

<sup>11</sup> Aneksi 4/3 i dosjes së ILDKPKI-së.

<sup>12</sup> Dosja hetimore e subjektit të rivlerësimit R.A.

rivlerësimit të saj ka paraqitur prova shkresore<sup>13</sup>, nga të cilat rezultoi se shtetasja M.T (D) është bashkëshortja e shtetasit G.J.T.

**26.4** DPSHTRR-ja<sup>14</sup> konfirmoi kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2016, nga shtetasi G.J.T, në vlerën 140,000 lekë. Gjithashtu u konfirmua se subjekti Ervin Aliu e ka shitur këtë automjet me kontratën nr. \*\*\* regj., datë 20.5.2019, vëllait të tij A.A në vlerën 100,000 lekë. Pas shitjes së automjetit është ndryshuar edhe targa nga \*\*\* në \*\*\*.

### Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë

**26.5** Subjekti në deklaratën *Vetting* ka shpjeguar se ky automjet është blerë *me të ardhurat e siguruara nga paga*. Kjo pasuri është deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 me të njëjtat të dhëna dhe burim krijimi të deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*. Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit deri në datën e blerjes së automjetit, e cila paraqitet në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 1**

Analiza financiare	1.1.2016 – 21.10.2016 (vlerat në lekë)
<b>Pasuritë</b>	<b>824,688</b>
Automjet tip “Daimler Chrysler”	540,920
Automjet tip “Mercedes-Benz”	140,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>143,768</i>
Gjendja e likuiditeteve	223,167
<b>Të ardhurat</b>	<b>3,113,077</b>
Paga e subjektit të rivlerësimit	785,340
Paga neto e bashkëshortes	989,470
Kredi bankare në Raiffeisen Bank 1.200.000 lekë	1,200,000
Interesa bankarë	3,267
Të ardhura nga shitja e automjetit me targë ***	135,000
<b>Shpenzimet</b>	<b>1,742,987</b>
Shpenzime jetike	587,730
Shpenzime udhëtimi	170,743
Shpenzime transporti	74,000
Shlyerje kredia 500.000 RZF	395,036
Shlyerje interes 45.990 RFZ	42,387
Shlyerje kredia 55.990 lekë	58,387
Shlyerje interes 1.200.000 lekë RFZ	213,153
Shlyer kredia 76.800 lekë UB	67,498
Blerje Cel	84,053
Shpenzime/komisione për kreditë	20,000
Shpenzime qiraje janar 12 – qershor 14 dhe mars 15 – maj 18	30,000
<b>Rezultati financiar</b>	<b><u>545,402</u></b>

### Vlerësimi i Komisionit

**26.6** Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në datën 21.10.2016.

<sup>13</sup> Certifikatë martese lëshuar më 18.2.2021; certifikatë familjare lëshuar më 18.2.2021; si dhe certifikatë personale lëshuar më 23.2.2021, përcjellë me pyetësin nr. 4, datë 17.2.2021.

<sup>14</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2021.

**27. Kontratë depozite bankare** në Bankën Kombëtare Tregtare, datë 5.8.2015, në shumën 220,000 lekë, e vendosur si garanci e kredisë bankare, e lehtësuar për blerje apartamenti, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2012. Gjendja në datën 23.1.2017 është në shumën 223,267.20 lekë, ku përfshihen interesat vjetorë të vitit 2016. Burimi i krijimit: kursime bashkëshortore, viti 2014. Pjesa takuese: 1/2 pjesë.

### **Fakte nga hetimi administrativ kryesisht**

**27.1** Nga hetimi rezultoi se me kontratën depozitë bankare në BKT, datë 5.8.2015, subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu ka çelur depozitë bashkëshortore me afat 1-vjeçar në shumën 220,000 lekë, me datë maturimi 4.8.2016.

**27.2** Kjo kontratë është deklaruar për herë të parë nga bashkëshortja e subjektit në DIPP-në e vitit 2015 me të njëjtat të dhëna si në deklaratën *Vetting*. Me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2017, lëshuar nga BKT, vërtetohet se znj. R.A ka depozitë në këtë bankë, me nr. \*\*\*, me gjendje në datën 23.1.2017, në shumën 223,267.20 lekë<sup>15</sup>.

**27.3** Nga hetimi rezultoi se burim për krijimin e gjendjes së kësaj depozite ka shërbyer vlera e transfertës 530,127.41 lekë nga shtetasi S.M në llogarinë e bashkëshortes në BKT, në datën 5.8.2015. Në të njëjtën datë, shuma 220,000 lekë është investuar në depozitë me afat 1-vjeçar dhe është vendosur si garanci për kredinë e marrë në shumën 4,950,000 lekë, sipas marrëveshjes siguruese me bllokim shume, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.9.2015, të nënshkruar midis BKT-së dhe znj. R.A, si dhe subjektit Ervin Aliu në cilësinë e dorëzanësit.

**27.4** Për shkak të marrëdhënieve ndërmjet subjektit dhe bashkëshortes, shtetasi S.M është vlerësuar në cilësinë e personit tjetër të lidhur në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

**27.5** Nga hetimi rezultoi se z. M ka qenë dy herë në marrëdhënie juridike, konkretisht në një marrëdhënie huaje të bashkëshortes së subjektit, e cila daton para lidhjes së martesës midis tyre, por edhe gjatë njohjes së tyre, siç deklarohej nga znj. A gjatë procesit të rivlerësimit të saj, si dhe si dorëzanës në një kredi të marrë nga kjo e fundit. Objekt në të dyja rastet ka qenë vlera 500,000 lekë.

**27.6** Në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit u trajtua pikërisht kontrata e dorëzanisë, e cila ka shërbyer në të njëjtën kohë për krijimin e llogarisë objekt shqyrtimi.

### **Lidhur me kontratën e dorëzanisë në vlerën 500,000 lekë**

**27.7** Nga hetimi<sup>16</sup> rezultoi se sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2012, në BKT, neni 9 “Sigurimi i kredisë”, paragrafi 9.1.2. është parashikuar se shtetasi S.M është dorëzanës në këtë kredi me depozitën në pronësi të tij prej 500,000 lekësh në BKT.

**27.8** Nga dokumentacioni bankar i administruar dhe deklaratimet e bashkëshortes gjatë procesit të saj të rivlerësimit<sup>17</sup> rezultoi se në datën 5.8.2015, shuma prej 530,127.41 lekësh është transferuar me transfertë bankare pranë BKT-së nga llogaria e shtetasit S.M, në llogari të personit të lidhur dhe të subjektit dhe z. M ka hequr dorë nga dorëzania. Kjo shumë prej 500,000 lekësh mbeti në pronësinë e të dyve dhe sipas deklarimeve të bashkëshortes së subjektit është përdorur prej tyre në këtë mënyrë: (i) në datën 5.8.2015 një pjesë e saj është tërhequr *cash* me qëllim shlyerjen e një pjese të mbetur nga një tjetër hua e dhënë nga z. S.M,

<sup>15</sup> Aneksi 4/4 dosja e ILDKPKI-së.

<sup>16</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2021, nga BKT.

<sup>17</sup> Shihni dosjen hetimore të subjektit dhe të R.A.



në shumën 500,000 lekë, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.6.2012<sup>18</sup>; (ii) në të njëjtën datë, pra 5.8.2015, shuma prej 220,000 lekësh, pjesë e depozitës 500,000 lekë është investuar në depozitë me afat 1-vjeçar dhe është vendosur si kolateral për kredinë e marrë 4,950,000 lekë, vërtetuar me marrëveshjen siguroese (me bllokim shume) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.9.2015, të nënshkruar midis BKT-së dhe shtetasve R.A dhe Ervin Aliu (në cilësinë e dorëzanësit).

**27.9** Rezultoi e provuar se shkak i transfertës së kësaj shume ka qenë se kjo kredi kishte një afat të gjatë dhe ai nuk mund të ishte për një kohë të gjatë dorëzanës i saj. Kjo rezultoi e provuar nga këto prova:

**a.** Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.4.2014, ku shtetasi S.M deklaron se shuma e depozitës bankare, lënë si garanci për të siguruar kredinë bankare, do t'i paguhet nga R.A (P) me 5 këste me nga 100,000 lekë, çdo 45 ditë. Sipas kësaj deklarate, kësti i parë prej 100,000 lekësh është paguar me nënshkrimin e kësaj deklarate.

**b.** Deklarata e thjeshtë me shkrim dore e datës 4.7.2014, ku shtetasi S.M deklaron se deri në këtë datë janë kryer tri pagesa nga znj. R.A (P) në këmbim të depozitës 500,000 lekë të vendosur si garanci për kredinë e marrë në BKT: (i) kësti i parë prej 100,000 lekësh është paguar në datën 4.4.2014; (ii) kësti i dytë prej 100.000 lekësh është paguar në datën 20.5.2014; (iii) kësti i tretë prej 100,000 lekësh është paguar në datën e nënshkrimit të kësaj deklarate 4.7.2014. Siç vërehet, kjo deklaratë është nënshkruar tre muaj me vonë se deklarata e parë, fakt që tregon se 300,000 lekë janë paguar brenda këtyre muajve: 4.4.2014 – 4.7.2014.

**c.** Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.12.2014, ku shtetasi S.M ka deklaruar se ka marrë prej shtetasës R.A (P) shumën 500,000 lekë, e cila i është paguar me këste jashtë kësaj zyre, në këmbim të depozitës bankare të tij nr. \*\*\*, në BKT, prej 500,000 lekësh, e lënë si garanci për të siguruar kontratën e kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. Më tej, ai deklaron se kjo është bërë për arsye se ai ka pasur nevojë për këtë shumë parash dhe duke pasur parasysh faktin se kjo depozitë duhet të qëndronte e bllokuar edhe për disa vite, ra dakord me znj. R.A (P) që t'i jepej nga ana e saj shuma 500,000 lekë, duke i kaluar si këmbim shuma e depozituar prej tij në BKT. Pra, sipas kësaj deklarate, shuma 200,000 lekë është paguar brenda periudhës 4.7.2014 – 29.12.2014.

**d.** Nga verifikimi i DIPP-së nuk rezultoi që subjekti dhe/ose bashkëshortja të kenë kryer deklarime për pagesat e kryera shtetasit S.M përgjatë vitit 2014, në total shuma 500,000 lekë dhe as pakësim likuiditetesh në këtë shumë sipas detyrimit ligjor. Komisioni e ka konsideruar si shpenzim në analizën financiare në vitin 2014, shumën 500,000 lekë.

**27.10** Komisioni kreu analizën financiare, të pasqyruar në tabelën nr. 2, lidhur me mundësinë e subjektit dhe bashkëshortes për shlyerjen e huas me burime: (i) kursimet nga paga në të cilën nuk janë përfshirë dietat e përfituara; (ii) hua nga E.C (K); (iii) mjetet monetare të siguruara nga një kredi bankare konsumatore në Raiffeisen Bank në datën 27.6.2014, nga e cila rezultoi se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për dhënien e shumave.

**Tabela nr. 2** (vlerat në lekë)

Analiza financiare	4.4.2014	20.5.2014	4.7.2014	31.12.2014	2014
<b>Pasuritë</b>	<b>141 996</b>	<b>45 422</b>	<b>303 707</b>	<b>530 065</b>	<b>1 021 191</b>
Dhënë cash tek z. S.M	100 000	100 000	100 000	200 000	500 000
Shtesa/pakësime likuiditeteve	41 996	-54 578	203 707	330 065	521 191

<sup>18</sup> Trajtimi i huas është administruar nga dosja e subjektit R.A (P).

Gjendja e likuiditeteve	-128 110	-182 688	21 020	351 085	351 085
<b>Të ardhurat</b>	<b>706 741</b>	<b>269 770</b>	<b>762 842</b>	<b>816 338</b>	<b>2 555 691</b>
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	353 315	96 104	115 510	485 115	1 050 044
Të ardhura nga paga e subjektit	293 526	73 666	147 332	331 223	845 747
Kredi bankare Raiffeisen Bank 59.900 lekë	59 900				59 900
Kredi bankare Raiffeisen Bank 500.000 lekë			500 000		500 000
Hua nga E.C 100,000 lekë		100 000			100 000
<b>Shpenzimet</b>	<b>257 226</b>	<b>106 089</b>	<b>120 907</b>	<b>588 960</b>	<b>1 073 181</b>
Shpenzime jetike	137 800	68 159	66 677	268 192	540 828
Shpenzime transporti	10 192	5 041	4 932	19 836	40 000
Shlyerje interesi 57,200 RFZ	12 198	8 132	4 066	24 396	48 792
Pagesë për kredinë 4,950,000 lekë BKT	10 500	7 000	3 500	21 000	42 000
Pagese për kredinë 310.500 lekë	26 636	17 757	8 879	53 271	106 543
Pagesë për kredinë 500,000 RZF			8 853	44 265	53 118
Shlyer huaja 500,000 lekë datë 29.6.2012				50 000	50 000
Shlyer huaja ndaj E.C				100 000	100 000
Blerje mallrash konsumi	59 900				59 900
Shpenzime/komisione për kreditë			20 000		20 000
Shpenzime qiraje (sipas pyetësorit Standard)			4 000	8 000	12 000
<b>Rezultati financiar</b>	<b>307 519</b>	<b>118 259</b>	<b>338 228</b>	<b>-302 687</b>	<b>461 319</b>
<b>Rezultati financiar kumulativ</b>					
<b>(Mundësia për kursime kumulative)</b>	<b>307 519</b>	<b>425 777</b>	<b>764 006</b>	<b>461 319</b>	<b>461 319</b>

## Vlerësimi i Komisionit

**27.11** Në përfundim, Komisioni çmon se bashkëshortja e subjektit ka pasur mundësi të shlyejë huat e marra prej saj, përpara se të fillonte detyrën subjekti i rivlerësimit, ndaj shtetasës E.C.

### Lidhur me mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur S.M<sup>19</sup>

**27.12** Nga hetimi rezultoi se në datën 25.2.2011, në Raiffeisen Bank, në llogarinë e shtetasit S.M është kredituar shuma 628,400 euro ose 87,303,612 lekë me përshkrimin “Sipas kontratës së shitjes së pronës datë 17.2.2011<sup>20</sup> dhe deklaratës noteriale datë 17.2.2011”. Ky fakt provon se burimi i të ardhurave të z. M është nga shitja e pronave, sikurse deklaruar nga subjekti.

**27.13** Nga dokumentacioni bankar i administruar duket se në datën 28.2.2011 një pjesë e kësaj shume është tërhequr *cash* dhe një pjesë është investuar në depozitë me afat. Shuma e tërhequr prej 286,532 euro (rreth 40 milionë lekë) është këmbyer në lekë dhe në po këtë datë ajo është investuar në depozita me afat. Shuma 1,000,000 lekë, e dhënë në total nga z. S.M, e ka origjinën tek shuma fillestare në lekë, e cila është investuar dhe riinvestuar në depozita me afat deri në datën 29.5.2012, datë pas së cilës shuma është lënë e lirë në llogari.

**27.14** Sa i takon pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga shitja, referuar informacionit të ASHK<sup>21</sup> Tiranë, drejtuar blerësit të pasurive, shtetasit K.U, kjo zyrë konfirmon se është kryer regjistrimi

<sup>19</sup> Shihni dosjen hetimore të subjektit R.A.

<sup>20</sup> Administruar nga dosja e bashkëshortes, përcjellë me pyetësorin nr. 1, me çmim në total në shumën 960,000 euro, nga të cilat 250,000 euro janë paguar në Union Bank dhe pjesa e mbetur prej 710,000 euro do të paguhet në RFZ Bank. Shuma 628,400 euro, kaluar në RFZ Bank datë 25.2.2011, është pjesë e këtij detyrimi, të përcaktuar në kontratë.

<sup>21</sup> Shihni dosjen hetimore të subjektit R.A (P).

i pasurisë në emër të këtij shtetasi dhe në bazë të Udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, kalimi i pronësisë nga shitësi tek blerësi prezumon pagesën e tatimit në burim nga ana e shitësit<sup>22</sup>.

**27.15** Në lidhje me mënyrën e kalimit të shumave nga z. M tek subjekti, nga lëvizjet e llogarive bankare pranë Raiffeisen Bank, të vëna në dispozicion nga bashkëshortja e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit të saj, në datën 26.7.2012 është tërhequr nga llogaria e z. S.M në këtë bankë shuma prej 500,000 lekësh dhe në të njëjtën datë ajo është depozituar *cash* në BKT, për t'u vendosur si garanci për kredinë e datës 19.9.2012.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**27.16** Në përfundim, Komision çmon se personi tjetër i lidhur ka pasur mundësi të krijojë me burime të ligjshme të ardhurat e llogarisë bankare të vendosura si garanci.

### **Lidhur me marrëdhëniet e subjektit me shtetasin S.M**

**27.17** Komisioni hetoi lidhur me marrëdhëniet e subjektit të rivlerësimit me shtetasin S.M. Komisioni iu drejtua subjektit me pyetësin nr. 2 për sqarime, lidhur mbi marrëdhënien e tij me shtetasin S.M, për të cilën sqaron: *“Në muajin qershor 2012 kam qenë në lidhje me znj. R.P, e cila më vonë u bë bashkëshortja ime. Në këtë periudhë ajo kishte nevojë për një hua që i nevojitej për të shlyer një kredi bankare në Raiffeisen Bank. E kemi diskutuar këtë problem së bashku. Nga ana ime, në ato momente nuk e kisha mundësinë që ta ndihmoja. Në këto rrethana, mora përsipër që ta ndihmoja nëpërmjet një mikut tim, konkretisht shtetasit S.M. Po ashtu, duke qenë se vjehrra ime aktuale, znj. H.P, ishte përfituese e një kredie të butë dhe vlera e apartamentit nuk e mbulonte shumën e kërkuar për kolateral, përsëri me ndërhyrjen time shtetasi S.M, meqë e kishte gjendje një depozitë në BKT, aty ku kërkohej edhe kolaterali, e vuri si garanci për garantimin e kredisë, pasi nga ana ime, Ervin Aliu, i është bërë e ditur që kjo shumë do t'i kthehej sapo të na krijohej mundësia. Sa më sipër, ju sqaroj se njihem dhe kam miqësi të hershme me z. S.M, prandaj dhe i jam drejtuar atij për ndihmë, në kushtet kur e dija se ai kishte mundësitë financiare për të më ndihmuar dhe me burime të ligjshme të pasurisë së tij, gjë të cilën e kemi provuar më parë para këtij Komisioni të nderuar”*. Gjithashtu sqaron se: *“... gjatë ushtrimit të detyrës sime si ndihmës ligjor nuk jam ndodhur asnjëherë në kushtet e ndonjë konflikti interesi, ku palë ndërgjyqëse në çfarëdolloj statusi të ketë qenë shtetasi S.M”*.

**27.18** Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.1.2021, lëshuar nga shtetasi S.M, në të cilën ai ka konfirmuar miqësinë e tij të hershme me shtetasin Ervin Aliu, si dhe vendosjen e kolateralit prej 500,000 lekësh për kredinë e marrë nga vjehrra e tij (nëna e znj. R.A). Po kështu, ka konfirmuar edhe dhënien e huas prej 500,000 lekësh në vitin 2012, subjektit të rivlerësimit dhe kthimin e saj totalisht në vitin 2015.

**27.19** Nga informacioni i marrë nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Përmet, ku bashkëshortja e subjektit ka ushtruar detyrën e saj të gjyqtares dhe në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ku dhe subjekti ka ushtruar detyrën e tij si ndihmës ligjor, nuk kanë rezultuar

---

<sup>22</sup> Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, pika 10 parashikon se: *“Pagesa e detyrimit tatimor bëhet para kryerjes së regjistrimit të aktit të kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurive të paluajtshme, në ZVRPP, në përputhje me aktet ligjore”*. Shihni dosjen hetimore të subjektit R.A.

procese gjyqësore apo vendime të dhëna nga gjyqtarja R.A (P) dhe të përpunuara nga ndihmësi ligjor Ervin Aliu me palë shtetasin S.M<sup>23</sup>.

**27.20** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka informuar se pranë kësaj gjykate është regjistruar çështja nr. \*\*\* akti, datë 18.4.2019, ku palë e tretë ka qenë shtetasi S.M. Kjo çështje fillimisht i është caktuar me short gjyqtares R.A (P), e cila ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila është pranuar dhe çështja është rishortuar duke i kaluar me short për gjykim një trupi tjetër gjykues.

**27.21** SPAK-u nuk ka konfirmuar procedime penale të regjistruara në emër të shtetasit S.M<sup>24</sup>.

**27.22** Nga hetimi rezultoi e provuar se z. S.M duket të ketë qenë shoku i subjektit të rivlerësimit dhe ka garantuar një kredi që ka marrë znj. R.P në vitin 2012, para lidhjes së martesës me subjektin, për blerje apartamenti për nënën e saj e, më vonë, edhe një kredi të dytë për subjektin e rivlerësimit. Duke qenë se nga hetimi nuk rezultoi e qartë marrëdhënia e subjektit dhe znj. R. me huadhënësin S.M, person tjetër i lidhur për shkak të huadhënieve, subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu iu kërkua të japë shpjegime lidhur me përdorimin e dy huave dhe shlyerjen e tyre, si dhe mbi marrëdhënien tij e të bashkëshortes me këtë shtetas.

**27.23** Në shpjegimet e tij, subjekti mban të njëjtin qëndrim duke shpjeguar me z. S.M njihet dhe ka miqësi të hershme, prandaj dhe i është drejtuar atij për ndihmë në kushtet kur e dinte se ai kishte mundësitë financiare për ta ndihmuar dhe me burime të ligjshme të pasurisë së tij, gjë të cilën e ka provuar më parë para këtij Komisioni. Në lidhje me bashkëshorten R.A (P), subjekti shprehet se kjo e fundit e ka njohur z. S.M nëpërmjet tij, si shokun tij, prandaj çdo veprim midis tyre është kryer në mirëbesim, duke qenë ai personi që i garantonte mbi korrektësinë e njëri-tjetrit.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**27.24** Në përfundim, Komisioni çmon se nuk u ngritën dyshime lidhur me marrëdhënien e subjektit dhe të personit të lidhur në raport me shtetasin S.M dhe huat e marra prej tij, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit.

**28. Veprim juridik, datë 12.10.2016, për shitblerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, nr. shasie \*\*\*, viti i prodhimit 1998, shitur për pjesë këmbimi. Shitësi Ervin Aliu. Vlera: 135,000 lekë. Pjesa takuese: bashkëpronësi bashkëshortore ½ pjesë.**

### **Fakte nga hetimi administrativ kryesisht**

**28.1** Nga hetimi ka rezultuar se me veprimin juridik të datës 12.10.2016, subjekti Ervin Aliu i ka shitur shtetasit G.J.P.T, për pjesë këmbimi, automjetin me nr. shasie \*\*\*, me targë të origjinës \*\*\*, në çmimin 135,000 lekë<sup>26</sup>, i cili i ka kaluar atij në rrugë bankare nga llogaria e shtetasës M.D nëpërmjet Raiffeisen Bank, në datën 20.10.2016. Këtë automjet subjekti e ka blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.10.2008, në shumën 5,500 euro.

<sup>23</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e subjektit R.A dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

<sup>24</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, nga SPAK në dosjen e administruar të subjektit R.A. Aneksi 4/5 dosja e ILDKPKI-së.

**28.2** Veprimi juridik datë 12.10.2016, për shitblerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, nr. shasie \*\*\*, viti i prodhimit 1998, është deklaruar nga subjekti Ervin Aliu në vitin 2016 me të njëjtat të dhëna si në deklaratën e pasurisë *Vetting*.

**28.3** Lidhur me burimin e krijimit të vlerës së blerjes prej 5,500 euro, nga një analizë e thjeshtë të ardhurat nga paga minus shpenzimet jetike rezultoi se subjekti Ervin Aliu ka pasur mundësi për të krijuar vlerën e blerjes së automjetit me të ardhura të ligjshme.

**Tabela nr. 3** (vlerat në lekë)

Të ardhurat	Kumulative 2007 – tetor 2008
Paga e subjektit të rivlerësimit transferuar pranë RBAL	1,064,971
Shpenzime jetike	250,470
Vlera e blerjes së automjetit	677,504
<b>Rezultati financiar</b>	<b>136,997</b>

**28.4** Në përfundim të hetimit, subjektit iu kërkuan shpjegime për faktin se nga analiza e pasurisë autoveturë me targë \*\*\*, tipi “Mercedes-Benz” C Class 180, blerë nga subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2016, nga shitësi GJ.P.T në vlerën 140,000 lekë, e trajtuar në pikën të vendimit dhe kësaj pasurie, e shitur për pjesë këmbimi, për vlerën 135,000 lekë po shtetasit GJ.P.T, duket se kemi të bëjmë me këmbimin e dy automjeteve dhe jo me shitje blerje të mirëfilltë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**28.5** Subjekti i rivlerësimit shpjegon ndër të tjera se: *“Palët kanë qenë të lira që midis tyre të lidhnin si kontratë shkëmbimi ashtu edhe kontrata shitblerjeje për tjetërsimin e automjeteve si më sipër, pasi që të dyja janë veprime juridike të ligjshme dhe të vullnetshme. Fakti që nga ana jonë janë lidhur kontrata shitblerjeje për secilin prej tyre kishte të bënte me kohën kur janë lidhur kontratat e shitjes dhe gjendjen teknike të secilit mjet. Mjeti i parë u ble nga ana ime për përdorim të përditshëm, pasi ishte në gjendje pune. Mjeti i dytë, konkretisht, ai tip “Mercedes-Benz”, nr. shasie \*\*\*, është shitur në bazë të bisedimeve të kryera midis palëve pas lidhjes së kontratës së parë dhe është blerë për pjesë këmbimi, pasi nuk ka qenë në gjendje pune”.*

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**28.6** Në përfundim të hetimit, Komisioni krijoi bindjen se këto veprime juridike kanë qenë reale dhe nuk krijojnë dyshime lidhur me deklarinimin e saktë dhe të mjaftueshëm të këtyre dy veprimeve juridike.

**29. Kontratë kredie bankare e lehtësuar** nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2012, për blerje apartamenti nga znj. H.P, shuma 4,950,000 lekë, interesi 3% në vit, afati 30 vjet, 15.11.2012 – 15.11.2042, kësti mujor 21,000 lekë/muaj. E ndryshuar me aneks-kontratën me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.9.2015, zëvendësohet dorëzanësi S.M nga Ervin Aliu dhe R.A, që sigurojnë këtë kredi me depozitën prej 220,000 lekësh. Shuma e detyrimit financiar të mbetur pa shlyer është 4,494,095.18 lekë.

#### **Fakte nga hetimi administrativ kryesisht**

**29.1** Gjatë hetimit nga aktet rezultoi se me kontratën e kredisë bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2012, me palë kredidhënëse BKT, palë kredimarrëse H.P (nëna e bashkëshortes së subjektit) dhe bashkëshortja e subjektit R.P, me dorëzanës shtetasit M.P (vëllai i

bashkëshortes së subjektit), B.P (vëllai i bashkëshortes subjektit), K.C dhe E.C (shitës të pasurisë që është vënë si garanci për kredinë, shitur nënës së bashkëshortes së subjektit H.P), si dhe S.M, kanë marrë nga BKT-ja kredinë në shumën 4,950,000 lekë.

**29.2** Për herë të parë kjo kredi është deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2012, nga bashkëshortja e subjektit (R.P me status beqare), pra para lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit (kredi bankare për blerje apartamenti në Y, Tiranë, në shumën 4,950,000 lekë). Referuar deklaratave periodike vjetore të viteve 2013 – 2016, znj. R.A (P) ka deklaruar shlyerje këstesh kredie në BKT për kredinë në fjalë.

**29.3** Kjo kredi është dhënë bazuar në: ligjin nr. \*\*\*, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”; VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”; udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”; si dhe në marrëveshjen tripalëshe datë 18.2.2009.

**29.4** Sipas aneksit të çeljes dhe përdorimit të kredisë, datë 19.9.2012, kreditimi do të përdoret nga kredimarrësi për blerje shtëpie.

**29.5** Sipas aneksit të elementeve specifike të kredisë së datës 19.9.2012, shuma e kredisë 4,950,000 lekë do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit në pronësi të shtetasve K e E.C dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit të objektit të kredituar K.C dhe E.C, me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së.

**29.6** Për marrjen e kësaj kredie janë vendosur si garanci pasuritë:

- i) apartament me sip. 92.7 m<sup>2</sup>, e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. pasurie \*\*\*, Y, Tiranë, e regjistruar në emër të K.C;
- ii) depozitë bankare me titullar S.M, në shumën totale 500,000 lekë, me nr. \*\*\*, në degën BKT, “\*\*\*”.

**29.7** Kredia në vlerën 5,000,000 lekë në BKT është disbursuar më 10.10.2012, nga e cila shuma prej 4,900,000 lekësh është transferuar nga llogaria e znj. H.P (nëna e bashkëshortes së subjektit), në llogarinë e shitësve të pasurisë K.C dhe E.C.

**29.8** Sipas aneks-kontratës së kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.9.2015, subjekti Ervin Aliu ofrohet dorëzanës për të siguruar kontratën e kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2012 dhe garancia e vendosur nga shtetasi S.M zëvendësohet me depozitën prej 220,000 lekësh në emër të znj. R.A (P).

**29.9** Duke qenë se bashkëshortja e subjektit ka qenë bashkëkredimarrëse në këtë kredi, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e një apartamenti banimi nga nëna e saj dhe në kushtet kur ka deklaruar rregullisht shlyerjet e kësteve të kredisë dhe shumat e detyrimeve të mbetura, Komisioni, gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit R.A (P), ka kryer hetime të thelluara, me qëllim vërtetimin e deklarimeve të saj, lidhjeve të saj me këtë pasuri, si dhe heqjen e çdo dyshimi që kjo pasuri mund të jetë një pasuri e subjektit të rivlerësimit R.A (P).

**29.10** Gjatë hetimit të kryer për procesin e rivlerësimit të subjektit R.A (P) nuk rezultuan problematika lidhur me këtë pasuri, dorëzanësit e saj, kushtet e marrjes së kredisë dhe burimin e ligjshmërisë së pagimit të saj, si dhe të drejtat reale të bashkëshortes së subjektit mbi këtë pasuri.

**29.11** Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është përfshirë si dorëzanës për një kredi të lidhur një vit para lidhjes së martesës, Komisioni çmon se elementet e vlerësimit të tij gjatë hetimit janë kufizuar në saktësinë e deklaramit dhe mundësinë e tij së bashku me bashkëshorten për të bërë të mundur pagesën e tyre me burime të ligjshme.

**29.12** Nga analiza financiare e Komisionit rezulton se pagesat e kredive janë kryer me burime të ligjshme të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

**29.13** Elementet e ligjshmërisë së kredisë së butë të marrë janë elemente që lidhen ekzaktësisht vetëm me procesin e rivlerësimit të bashkëshortes, e cila ka qenë subjekt rivlerësimi, që është vlerësuar si e ligjshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**29.14** Në përfundim, nga hetimi i Komisionit konstatohet se nuk rezultojnë problematika në lidhje me kontratën e kredisë bankare në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR/BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT**

**30. Tokë arë, “toka e re”, pasuria nr. \*\*\***, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sip. 16.000 m<sup>2</sup>, sipas AMTP nr. \*\*\* dhe 14.425 m<sup>2</sup> sipas LN, shkurt 1996, ndodhur në fshatin G, z. k. \*\*\*, Elbasan. Vërtetim datë 23.1.2017 i ZVRPP Elbasan bashkëngjitur, AMTP datë 15.11.1991, në emër të shtetasit H.P. Vlera: 3.552.000 lekë për sipërfaqen 16.000 m<sup>2</sup>. Vlera: 3.202.350 lekë për sip. 14.425 m<sup>2</sup>. Llogaritur sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016. Pjesa takuese: 1/7 pjesë (1/8 pjesë në bazë të AMTP+1/7 e 1/8 pjesë me trashëgimi).

### **Fakte nga hetimi administrativ kryesisht**

**30.1** Rezultoi se me AMTP-në e datës 15.11.1991 shtetasit H.M.P [babai i bashkëshortes R.A (P) i jepet në pronësi tokë në fshatin G. gjithsej 30.500 m<sup>2</sup>, nga e cila parcela “Toka e re” me sip. 16.000 m<sup>2</sup>, në përbërjen familjare të të cilit, në momentin e përfitimit të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501 kanë qenë tetë persona, një prej të cilëve znj. R.A (P), vërtetuar me certifikatat familjare më 25.1.2017.

**30.2** Sipas vërtetimit të datës 23.1.2017, të ZVRPP Elbasan, vërtetohet regjistrimi i kësaj pasurie në emër të shtetasit H.M.P si përfaqësues i familjes bujqësore, si pasuria nr. \*\*\* e llojit arë, me sip. 16.000 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe sip. 14 425 m<sup>2</sup>, sipas LN shkurt 1996 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin G, z. k. \*\*\*, Elbasan.

**30.3** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.3.2017 (pas vdekjes së shtetasit H.P në datën 30.11.2000), janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, një prej të cilëve është znj. R.A (P), e cila trashëgon 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore.

**30.4** Në deklaratën e interesave privatë “Para fillimit të detyrës 2009”, znj. R.A ka deklaruar pasurinë tokë arë me sip. 14.423 m<sup>2</sup>, në B, Elbasan, përfituar me ligjin “Për tokën” v. 1991, pjesa që zotëron 25%.

**30.5** Në deklaratën periodike vjetore 2016 znj. R.A (P) ka deklaruar pasurinë tokë arë me sip. 16.000 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe 14.425 m<sup>2</sup> sipas LN shkurt 1996 në G, Elbasan, të përfituar me ligjin “Për tokën” v. 1991, pjesa që zotëron 1/7 (1/8 pjesë në bazë të AMTP +1/7 e 1/8 pjesë trashëgimi).

**30.6** ASHK Elbasan<sup>25</sup> ka konfirmuar se znj. R.H.A (P) ka në bashkëpronësi me shtetasit H.H.P, N.H.P, F.H.T, M.H.P, E.H.LL dhe B.H.P, pasurinë nr. \*\*\*, të llojit arë, z. k. \*\*\*, G.

**31. Tokë arë, “Kopshti i P”, pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sip. 11.750 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe 13.295 m<sup>2</sup> sipas LN shkurt 1996, ndodhur në fshatin G, z. k. \*\*\*, Elbasan. Vërtetim datë 23.1.2017 i ZVRPP Elbasan bashkëngjitur AMTP-së datë 15.11.1991 në emër të shtetasit H.P. Vlera: 2,608,500 lekë për sipërfaqen 11.750 m<sup>2</sup>; Vlera: 2,951,490 lekë për sip. 13,295 m<sup>2</sup>. Llogaritur sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016. Pjesa takuese: 1/7 pjesë (1/8 pjesë në bazë të AMTP +1/7 e 1/8 pjesë me trashëgimi).**

#### **Fakte nga hetimi administrativ kryesisht**

**31.1** Rezulton se me AMTP-në e datës 15.11.1991, shtetasit H.M.P [babait të znj. R.A (P)] i jepet në pronësi tokë në fshatin G. gjithsej 30.500 m<sup>2</sup>, nga e cila parcela “Kopshti i P” me sip. 12.000 m<sup>2</sup>, në përbërjen familjare të të cilit, në momentin e përfitimit të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501, kanë qenë tetë persona, një prej të cilëve znj. R.A (P), vërtetuar me certifikatat familjare më 25.1.2017.

**31.2** Sipas vërtetimit të datës 23.1.2017 të ZVRPP Elbasan, vërtetohet se në pronësi të shtetasit H.M.P, si përfaqësues i familjes bujqësore, figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\* vol. \*\*\*, f. \*\*\* e llojit arë, me sip. 11.750 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe sip. 13.295 m<sup>2</sup>, sipas LN shkurt 1996 m<sup>2</sup> e ndodhur në fshatin G, z. k. \*\*\* Elbasan.

**31.3** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.3.2017 (pas vdekjes së shtetasit H.P në datën 30.11.2000), janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, një prej të cilëve është znj. R.A (P), e cila trashëgon 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore.

**31.4** Në deklaratën e interesave private “Para fillimit të detyrës 2009”, znj. R.A ka deklaruar pasurinë tokë arë me sip. 13.295 m<sup>2</sup>, në B, Elbasan, përfituar me ligjin “Për tokën” v. 1991, pjesa që zotëron 25%.

**31.5** Në deklaratën periodike vjetore 2016, znj. R.A (P) ka deklaruar pasurinë tokë arë me sip. 11,750 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe sip. 13.295 m<sup>2</sup> sipas LN shkurt 1996 në G, Elbasan, të përfituar me ligjin “Për tokën” v. 1991, pjesa që zotëron 1/7 (1/8 pjesë në bazë të AMTP +1/7 e 1/8 pjesë trashëgimi).

**31.6** ASHK Elbasan<sup>26</sup> ka konfirmuar se znj. R.H.A (P) ka në bashkëpronësi me shtetasit H.H.P, N.H.P, F.H.T, M.H.P, E.H.LL dhe B.H.P pasurinë nr. \*\*\*, të llojit arë, z. k. \*\*\*, G.

**32. Tokë arë, “Kopshti i P”, pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sip. 2.070 m<sup>2</sup> sipas LN shkurt 1996, ndodhur në fshatin G, z. k. \*\*\*, Elbasan (pasuritë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* i korrespondojnë pasurisë nr. \*\*\* të AMTP \*\*\*, sipërfaqja është pasqyruar në pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*). Vërtetim datë 23.1.2017 i ZVRPP Elbasan bashkëngjitur AMTP-së datë 15.11.1991, në emër të shtetasit H.P. Vlera: 459,540 lekë, për sip. 2,070 m<sup>2</sup>. Llogaritur sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016. Pjesa takuese: 1/7 pjesë (1/8 pjesë në bazë të AMTP +1/7 e 1/8 pjesë me trashëgimi).**

#### **Fakte nga hetimi administrativ kryesisht**

<sup>25</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, nga ASHK Elbasan në dosjen e Komisionit për subjektin R.A (P).

<sup>26</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, nga ASHK Elbasan në dosjen e Komisionit për subjektin R.A (P).



**32.1** Rezultoi se me AMTP-në e datës 15.11.1991 shtetasit H.M.P [babait të znj. R.A (P)] i jepet në pronësi tokë në fshatin G, gjithsej 30.500 m<sup>2</sup>, nga e cila parcela “Kopshti” me sip. 12.000 m<sup>2</sup>, në përbërjen familjare të të cilit, në momentin e përfitimit të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501, kanë qenë tetë persona, një prej të cilëve znj. R.A (P), vërtetuar me certifikatat familjare më 25.1.2017.

**32.2** Sipas vërtetimit të datës 23.1.2017 të ZVRPP Elbasan, vërtetohet se në pronësi të shtetasit H.M.P, si përfaqësues i familjes bujqësore, figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit arë, me sip. 2070 m<sup>2</sup> sipas LN shkurt 1996, ndodhur në fshatin G, z. k. \*\*\*, Elbasan (pasuritë nr. \*\*\*, \*\*\* i korrespondojnë pasurisë nr. \*\*\* të Aktit \*\*\*. Sipërfaqja është pasqyruar në pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*).

**32.3** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.3.2017 (pas vdekjes së shtetasit H.P në datën 30.11.2000), janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, një prej të cilëve është znj. R.A (P), e cila trashëgon 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore.

**32.4** Në deklaratën e interesave privatë “Para fillimit të detyrës 2009”, znj. R.A ka deklaruar pasurinë tokë arë, me sip. 2.070 m<sup>2</sup>, në B, Elbasan, përfituar me ligjin “Për tokën”, v. 1991, pjesa që zotëron 25%.

**32.5** Në deklaratën periodike vjetore 2016, subjekti R.A (P) ka deklaruar pasurinë tokë arë me sip. 2.070 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\*, në G, Elbasan, të përfituar me ligjin “Për tokën”, v. 1991, pjesa që zotëron 1/7 (1/8 pjesë në bazë të AMTP +1/7 e 1/8 pjesë trashëgimi).

**32.6** ASHK Elbasan<sup>27</sup> ka informuar se znj. R.H.A (P) ka në bashkëpronësi me shtetasit H.H.P, N.H.P, F.H.P, M.H.P, E.H.LL dhe B.H.P pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, të llojit arë, z. k. \*\*\*, G.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**32.7** Në përfundim të hetimit, Komisioni çmon se personi i lidhur i ka përfituar në bazë e për zbatim të ligjit nr. 7501, “Për tokën” dhe nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

**33. Tokë truall, pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sip. 250 m<sup>2</sup>, nga ku ndërtesë me sip. 145 m<sup>2</sup> ndodhur në fshatin G, z. k. \*\*\*, Elbasan. Vlera: 86.250 lekë për 250 m<sup>2</sup> truall, llogaritur sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016. Vlera: 50.750 lekë ndërtimi 145 m<sup>2</sup>. Pjesa takuese: 1/7 pjesë (1/8 pjesë në bazë të AMTP +1/7 e 1/8 pjesë me trashëgimi) truall+banesë.**

**33.1** Nga hetimi rezultoi e provuar se me AMTP-në e datës 15.11.1991, shtetasit H.M.P [babai i znj. R.A (P)] i jepet në pronësi tokë në fshatin G gjithsej 30.500 m<sup>2</sup>, nga e cila parcela “Kopshti i P” me sip. 12.000 m<sup>2</sup>, në përbërjen familjare të të cilit, në momentin e përfitimit të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501, kanë qenë tetë persona, një prej të cilëve znj. R.A (P), vërtetuar me certifikatat familjare më 25.1.2017.

**33.2** Sipas vërtetimit të datës 23.1.2017 të ZVRPP Elbasan, vërtetohet se në pronësi të shtetasit H.M.P, si përfaqësues i familjes bujqësore, figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, e llojit arë me sip. 250 m<sup>2</sup>, nga ku ndërtesë është 145 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin G, z. k. \*\*\* Elbasan.

---

<sup>27</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, nga ASHK Elbasan në dosjen e Komisionit për subjektin R.A (P).

**33.3** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.3.2017 (pas vdekjes së shtetasit H.P në datën 30.11.2000), janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, një prej të cilëve është edhe bashkëshortja R.A (P), e cila trashëgon 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore.

**33.4** Në deklaratën e interesave privatë “Para fillimit të detyrës 2009”, znj. R.A ka deklaruar vetëm pasurinë truall me sip. 250 m<sup>2</sup> në B, Elbasan, përfutuar me ligjin “Për tokën”, v. 1991, pjesa që zotëron 25%.

**33.5** Në deklaratën periodike vjetore 2016, znj. R.A (P) ka deklaruar pasurinë tokë truall me sip. 250 m<sup>2</sup>, nga ku ndërtesë 145 m<sup>2</sup> në G, Elbasan, të përfutuar me ligjin “Për tokën”, v. 1991, pjesa që zotëron 1/7 (1/8 pjesë në bazë të AMTP +1/7 e 1/8 pjesë trashëgimi).

**33.6** ASHK Elbasan<sup>28</sup> ka informuar se znj. R.H.A (P) ka në bashkëpronësi me shtetasit H.H.P, N.H.P, F.H.P, M.H.P, E.H.LL dhe B.H.P pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, të llojit truall, z. k. \*\*\* G.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**33.7** Në përfundim, Komisioni në vlerësim të provave të administruara çmon se banesa në fshatin G, Elbasan, është ndërtuar dhe përdorur në një periudhë të hershme nga familja e origjinës së saj nga babai, ndërsa znj. R.A (P) ka banuar në të me familjen deri në vitin 2006, kur është larguar për të ndjekur studimet e magjistraturës në Tiranë. Për rrjedhojë, nuk u vërtetuan investime të kryera nga znj. R.P mbi këtë pasuri.

### **GJETJE TË TJERA LIDHUR ME ADRESAT E BANIMIT TË DEKLARUARA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT**

**34.** Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në Gjendjen Civile”, subjekti ka deklaruar adresën “Rruga “\*\*\*\*” \*\*\*, p. nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë”. Në rubrikën “Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni”, subjekti ka deklaruar adresën “Durrës, Lagjia Nr. \*\*\*, Rruga “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, ap. \*\*\*\*”.

**34.1** ILDKPKI-ja për të dyja këto adresa ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar:

- të ketë në pronësi pasuri të paluajtshme në adresat e mësipërme;
- të ketë marrë me qira pasuri të paluajtshme në adresat e mësipërme;
- të ketë në posedim ose në përdorim pasuri të paluajtshme në adresat e mësipërme.

**34.2** Nga hetimi rezultoi se deklaratimet e subjektit dhe bashkëshortes për adresat e banimit rezultojnë si vijon:

**34.2.1** Në DPV-në 2012, znj. R.P deklaroi adresë banimi tjetër (të ndryshme nga ajo që ka deklaruar më parë me familjen e saj), dhe konkretisht adresën në *Njësinë Bashkiake Nr. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*” ( DIPP 2009 – 2011) dhe adresën në Lagjen Y, rr. “\*\*\*\*” (tek A) pallati i firmës “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*.*

**34.2.2** Në DIPP-në 2013, subjekti si person i lidhur me bashkëshorten (martuar në shkurt 2013) ka deklaruar si adresë banimi *Lagjia “Y”, rr. “\*\*\*\*” (tek A), pallati i firmës “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, shk. \*\*\**, adresë kjo e njëjtë më atë të deklaruar nga bashkëshortja.

---

<sup>28</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.05.2020, nga ASHK Elbasan në dosjen e Komisionit për subjektin R.A (P).

**34.2.3** Në DIPP-në 2014, subjekti deklaroi si adresë banimi *Lagjja "Y"*, rr. "\*\*\*\*" (tek A), *pallati i firmës "\*\*\*\*"*, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, deklarim i njëjtë me bashkëshorten.

**34.2.4** Në DIPP-në 2015, subjekti deklaroi si adresë *Lagjja "\*\*\*\*"*, rr. "\*\*\*\*", *pallati i firmës "\*\*\*\*"*, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*. Bashkëshortja nuk deklaroi adresë banimi në këtë DPV.

**34.2.5** Në DIPP-në 2016, subjekti deklarues (plotësuar dhe dorëzuar në kohë pas deklarimit *Vetting*) deklaroi adresë banimi *Durrës, Lagjja Nr. \*\*\*, rr. "\*\*\*\*", p. \*\*\*, ap. \*\*\*\**. Këtë deklarim bën edhe bashkëshortja e subjektit.

**34.2.6** Në pyetësin nr. 1, subjekti deklaroi adresë banimi *banesa e ndodhur në Durrës, z. k. \*\*\*\*, numri i pasurisë \*\*\*\*, adresa: Lagjja Nr. \*\*\*, rruga "\*\*\*\*", pallati nr. \*\*\*\*, apartamenti \*\*\*\**, si dhe *Banesa e ndodhur në S, F, Tiranë, z. k. \*\*\*\*, Numri i Pasurisë \*\*\*\*, adresa Lagjja Nr. \*\*\*, rruga "\*\*\*\*", ndërtesa nr. \*\*\*\*, hyrja \*\*\*\*, ap. \*\*\*\**. Duket se ai shmang çdo deklarim lidhur me adresat e banimit të deklaruara prej tij ndër vite nëpërmjet bashkëshortes.

**34.2.7** Nga dokumenti i gjendjes civile duket se nëna e subjektit vijon të jetojë prej vitit 2014 në Kashar.

**34.3** Në përfundim të hetimit, subjektit i kaloi barra e provës, ku duket se pasuria apartament banimi, blerë në vitin 2012, ndodhet në Y dhe është adresa e deklaruar, ku ka banuar subjekti i rivlerësimit me bashkëshorten e tij. Subjektit iu kërkua të shpjegojë lidhur me adresat e banimit të deklaruara prej tij dhe bashkëshortes ndër vite, të cilat duket se nuk janë sqaruar nga ai në pyetësin nr. 1, duke paraqitur dokumentacion për secilin rast të deklaruar.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**34.4** Në lidhje me adresën e deklaruar, rruga "\*\*\*\*", pall. nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, \*\*\*, Tiranë, subjekti shpjegon se: *"Bëhet fjalë për banesën e ndodhur në Njësinë Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë, rruga "\*\*\*\*", Pallati i Policisë F, shk. \*\*\*, kati \*\*\*\*, në të cilën ka banuar bashkëshortja ime për periudhën nëntor 2006 deri në datën 20.11.2012. Kjo banesë është marrë me qira nga nëna e bashkëshortes sime H.P dhe aty ka jetuar familja e saj deri kur është blerë prej saj apartamenti i ndodhur në Y-K, Tiranë, z. k. \*\*\*\*, numri i pasurisë \*\*\*\*, adresa rruga "\*\*\*\*", ap. \*\*\*\*. Nga verifikimi në Google Maps, rruga "\*\*\*\*", deklaruar në pyetësin standard nga bashkëshortja ime gjatë procesit të saj të rivlerësimit, dhe rruga "\*\*\*\*", deklaruar në deklaratën *Vetting*, janë shumë pranë njëra-tjetrës dhe ky duket të jetë shkak që emri i rrugës në deklaratën *Vetting* nuk përputhet me rrugën e pasurisë së marrë me qira nga nëna e bashkëshortes sime (sqaruar në vendimin nr. 472, datë 22.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pika 1.1, faqe 30). Pronarët e objektit si më sipër janë shtetasit H dhe A.M. Për shkak të kohës së gjatë, nëna e bashkëshortes sime H.P, e cila ka hyrë në marrëdhënie kontraktore qiramarrjeje me shtetasit H dhe A.M, nuk disponon ndonjë dokument. Jam interesuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile dhe as ata nuk disponojnë ndonjë dokument".* Më tej, në shpjegime subjekti shprehet se martesja e tyre është bërë në datën 14.2.2013, në Zyrën e Gjendjes Civile Nr. \*\*\*, Tiranë. Fillimisht deklaroi se është regjistruar në përbërjen familjare të bashkëshortes, aty ku rezultonte e regjistruar zyrtarisht banore bashkëshortja dhe familja e saj e origjinës dhe se, disa muaj më vonë, ai dhe bashkëshortja kanë bërë ndarjen dhe kanë dalë si familje më vete, duke mbetur formalisht si adresë e gjendjes civile ajo e përshkruar më sipër, deri kur u vendosën përfundimisht për të banuar në mënyrë të përhershme në Tiranë, në banesën e marrë me qira, në adresën S, F, Tiranë, z. k. \*\*\*\*, numri i pasurisë \*\*\*\*, adresa Lagjja Nr. \*\*\*, rruga "\*\*\*\*", ndërtesa nr. \*\*\*\*, hyrja \*\*\*\*, ap. \*\*\*\*.

Bashkëlidhur me prapësimet, subjekti ka paraqitur disa akte të zyrës së gjendjes civile dhe kopje të deklaratës noteriale datë 2020, të lëshuar nga shtetasit H dhe A.M.<sup>29</sup>.

**34.5** Në lidhje me adresën e deklaruar lagjja “Y”, rr. “\*\*\*\*” (tek A), pallati i firmës “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*\*, shk. \*\*\*\*, subjekti i rivlerësimit shpjegon se bëhet fjalë për banesën e ndodhur në Y-K, Tiranë, z. k. \*\*\*\*, numri i pasurisë \*\*\*\*, adresa rruga “\*\*\*\*”, apartamenti nr. \*\*\*\*, me pronare znj. H.H.P. Në këtë apartament deklarohet se ka banuar në mënyrë të përhershme bashkëshortja e tij nga data 20 nëntor 2012 deri në lidhjen e martesës, datë 14.2.2013, si dhe në raste e ditë të caktuara pas kësaj date për shkak të lidhjeve të origjinës. Këtë e provon me certifikatën për vërtetim pronësie \*\*\*\*, lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë dhe kartelën për pasurinë nr. \*\*\*\*, me pronare shtetasen H.P.

**34.6** Në lidhje me adresën e deklaruar Lagjja Nr. \*\*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*\*, ap. \*\*\*\*, subjekti shpjegon se bëhet fjalë për banesën e ndodhur në Durrës, z. k. \*\*\*\*, numri i pasurisë \*\*\*\*, pronarë të së cilës kanë qenë prindërit dhe vëllai i tij. Në këtë banesë deklarohet se ka banuar deri në gusht 2019, kur janë zhvendosur familjarisht për të jetuar në banesën e marrë me qira të ndodhur në S, F, Tiranë, adresa Lagjja Nr. \*\*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, ndërtesa nr. \*\*\*\*, hyrja \*\*\*\*, ap. \*\*\*\*, me pronar shtetasin R.S.J. Këtij shpjegimi subjekti i bashkëlidh akte të regjistrimit të pasurisë nr. \*\*\*\* dhe akte të tjera në emër të shtetasit R.A.<sup>30</sup>

**34.7** Në lidhje me adresën e deklaruar rr. “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, shk.\*\*\*\*, ap. \*\*\*\*, subjekti shpjegon se bëhet fjalë për banesën e ndodhur në S, Tiranë, z. k. \*\*\*\*, numri i pasurisë \*\*\*\*, pronarë të së cilës kanë qenë prindërit e tij R dhe M.A dhe se qëndrimi në këtë apartament ka qenë sporadik, me ditë të caktuara dhe jo i përvetshëm. Këtë fakt e vërteton nëpërmjet kopjes së certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 30.12.2015 për pasurinë nr. \*\*\*\*, me pronare shtetasen M.M.A.

**34.8** Në lidhje me adresën S, F, Tiranë, z. k. \*\*\*\*, numri i pasurisë \*\*\*\*, adresa Lagjja Nr. \*\*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, ndërtesa nr. \*\*\*\*, hyrja \*\*\*\*, ap. \*\*\*\*, subjekti shpjegon se në këtë adresë ndodhet banesa me pronar shtetasin R.S.J, ku ai dhe familja e tij jetojnë nga muaji shtator 2019 dhe në vazhdim, në bazë të kontratave të qirave të datave 4.9.2019, 11.9.2020, 3.12.2021 dhe 22.12.2022.<sup>31</sup> Në përfundim të shpjegimeve, subjekti deklarohet se ka deklaruar vetëm adresat

<sup>29</sup> Shkresa “Kthim përgjigje e ZGJC” nr. \*\*\*\* prot., datë 28.1.2020, e Njesisë Bashkiake Nr. \*\*\*\*, Tiranë.

- Deklarata noteriale nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 28.1.2020, të lëshuar nga shtetasit H dhe A.M.

- Vërtetim nga dokumentet hipotekore;

- Certifikatë martese nr. \*\*\*\*, lëshuar në datën 28.3.2014 nga ZGJC, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*\*, Tiranë;

- Certifikatë familjare nr. \*\*\*\*, lëshuar në datën 17.1.2020 nga ZGJC, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*\*, Tiranë;

- Certifikatë familjare nr. \*\*\*\*, lëshuar në datën 28.3.2014 nga ZGJC, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*\*, Tiranë;

- Certifikatë familjare nr. \*\*\*\*, lëshuar në datën 21.1.2021 nga ZGJC, Bashkia Durrës;

- Certifikatë familjare nr. \*\*\*\*, lëshuar në datën 21.1.2021 nga ZGJC, Bashkia Durrës.

<sup>30</sup> Vërtetim nga dokumentet hipotekore për pasurinë nr. \*\*\*\*, lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në datën 22.6.2012.

- Inventari i brendshëm i dosjes datë 8.1.2008, bashkëlidhur: autorizim nga Komiteti Ekzekutiv K. P. i qytetit Durrës, datë 16.1.1984; mandatpagesë nr. \*\*\*\*; mandatpagesë nr. \*\*\*\*; formular nr. 3; kontratë për privatizimin e banesës, datë 22.12.1993, e lidhur midis NK Banesa dhe qiramarrësit R.A; formulari nr. 2 (treguesit kryesorë të apartamentit); certifikatë e përbërjes familjare e datës 1.12.92 e R.A, e lëshuar nga ZGJC Durrës në datën 20.12.1993; akti i dhënies dhe i marrjes në dorëzim të banesës shtetërore, datë 1.3.1984; kontratë shitblerjeje datë 23.12.1993; planvendosje dhe planimetria e apartamentit.

- Certifikatë familjare R.A, nr. \*\*\*\*, lëshuar në datën 22.1.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile, Durrës ZGJC \*\*\*\*;

- Certifikatë familjare R.A, nr. \*\*\*\*, lëshuar në datën 22.1.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile, Durrës ZGJC \*\*\*\*;

- Certifikatë familjare R.A, nr. \*\*\*\*, lëshuar në datën 22.1.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile, Durrës ZGJC \*\*\*\*;

- Certifikatë familjare R.A, nr. \*\*\*\*, lëshuar në datën 22.1.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile, Durrës ZGJC \*\*\*\*.

- Kontratë shitjeje apartamenti nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 26.8.2019.

<sup>31</sup> Kontrata e qirasë nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 4.9.2019, bashkëlidhur: certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë nr. \*\*\*\*; autorizim i lëshuar në Frankfurt, datë 16.4.2019, nga pronari R.S.J shtetasit D.L.M për lidhjen e kontratës së qirasë, i përkthyer në gjuhën shqipe; vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\*\* rep., datë 4.9.2019; foto të dokumentit identifikues të shtetasit Ervin R. Aliu dhe personit të autorizuar për lidhjen e kontratës së qirasë, të shtetasit D.L.M.

ku ka qëndruar në mënyrë të përhershme dhe se nuk ka pasur asnjë qëllim të shmangë deklarimin lidhur me adresat e banimit të deklaruara prej tij ndër vite nëpërmjet bashkëshortes në deklaratat vjetore periodike. Sipas subjektit, kjo pasaktësi në deklaram ka ardhur si rrjedhojë e faktit se nga periudha 2013 e deri në vitin 2018 bashkëshortja e tij ka punuar në qytetin e Përmetit, ndërsa ai jetonte në Tiranë dhe në disa raste e ditë të caktuara kanë jetuar si tek banesa në Tiranë në pronësi të prindërve të tij, ashtu edhe në atë në pronësi të nënës së bashkëshortes. Arsyeja dhe qëllimi që janë deklaruar ato adresa sipas subjektit, ka qenë për faktin që të kishin një adresë për njoftim nga ILDKPKI-ja, pra që të kishin një vendbanim zyrtar në Tiranë.

**35.** Pas zhvillimit të seancës dëgjimore, trupi gjykues, me vendimin nr. 5, datë 28.3.2024, vendosi të rihapë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, me qëllim që të hetohet lidhur me adresat e banimit të deklaruara nga ai dhe bashkëshortja e tij.

### **Hetimi i Komisionit pas rihapjes së hetimit administrativ**

**35.1** Referuar shpjegimeve dhe dokumentacionit të dërguar nga subjekti i rivlerësimit dhe të dhënave të administruara pas rihapjes së hetimit, ka rezultuar sa vijon:

**35.2 Për sa i përket adresës së banimit lagjja “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*” (tek A), pallati i firmës “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, shk. \*\*\***

**35.2.1** Komisioni u informua nga komunikimi me FSHU-në<sup>32</sup> se kontrata për adresën e banimit të ndodhur në Y ishte lidhur në datën 12.9.2009 dhe se ndryshimi i emrit të kontratës nga ajo e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në znj. H.P ishte kryer në datën 28.10.2013. Gjithashtu, u informua mbi konsumin mujor të kontratës \*\*\*, nga e cila rezulton se faturimi i konsumit fillon prej muajit tetor 2012 e në vijim.

**35.2.2** Ndërsa në lidhje me kontratën për adresën tjetër të nënës së bashkëshortes<sup>33</sup>, të ndodhur në instancën Elbasan, me nr. \*\*\*, në kabinën B, G, rezulton se është lidhur në datën 30.9.2005, për të cilën konsumi për periudhën dhjetor 2019 – shkurt 2024 është fiks çdo muaj, me vlerë minimale prej 340 lekë/muaj.

**35.2.3** Gjithashtu, nga komunikimi me UKT-në<sup>34</sup> rezultoi se znj. H.P ka lidhur kontratë furnizimi nr. \*\*\* për objektin e ndodhur në Y, lidhur në nëntor 2010 dhe me konsum që fillon prej vitit 2012.

**35.3 Për sa i përket adresës së banimit lagjja “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, pallati i firmës “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, shk. \*\*\***

**35.3.1** Pas riçeljes së hetimit, Komisioni u informua nga komunikimi me FSHU-në<sup>35</sup> se kontrata për adresën e banimit lagjja “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*”, pallati i firmës “\*\*\*\*”, ishte lidhur në datën 18.10.2013, me nr. kontrate \*\*\* dhe se aktualisht është në emër të shtetasit I.Q.I. Ndryshimi i emrit të kontratës ka ndodhur në datën 3.3.2016 dhe, më pas, në datën 9.11.2017. Përcillet bashkëlidhur edhe formulari i ndryshimit të të dhënave personale, datë 20.1.2020, në të cilin është kërkuar nga shtetasi I.I ndryshimi i emrit të kontratës, e cila ishte në emër të

---

- Kontrata e qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.9.2020;  
- Kontrata e qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.12.2021;  
- Kontrata e qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.12.2022.

<sup>32</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2024.

<sup>33</sup> Të deklaruar nga bashkëshortja gjatë procesit të saj të rivlerësimit.

<sup>34</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2024.

<sup>35</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.5.2024.

shtetases M.A; certifikatë pasurie në emër të I.I, plus kartelë pasurie; kopje të kontratës së lidhur në datën 4.8.2018 midis znj. M.A (pala shitëse) dhe z. I.I (pala blerëse).

**35.3.2** Komisioni u informua edhe mbi konsumin mujor të kontratës, nga ku rezultoi se ka pasur konsum prej muajit nëntor të vitit 2013 në nivele të ulëta dhe, më pas, prej muajit mars 2014 deri në shkurt 2017 konsumi ka qenë i luhatshtëm, por jo minimal, ndërsa prej marsit 2017 e në vijim kontrata e furnizimit rezultoi me konsum të vazhdueshëm të energjisë elektrike.

**35.3.3** Ndërsa nga UKT-ja<sup>36</sup> për këtë adresë rezultoi e lidhur kontrata me nr. \*\*\* në emër të shtetasit R.X. Përcillet bashkëlidhur kopje e kontratës së sipërmarrjes për punime ndërtimi e datës 10.3.2007, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., midis palës pronar trualli, z. R.X dhe palës investitore, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Përcillet edhe konsumi mujor prej muajit shtator 2013 e në vijim, ku informohemi se konsumi më i lartë ka qenë për periudhën në pronësi të nënës së subjektit, në muajt shtator – tetor 2014 dhe korrik 2015.

**35.3.4** Nga leximi i konsumit të kontratave të furnizimit me energji elektrike dhe ujë rezultoi se apartamenti me adresë lagjja “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*”, pallati i firmës “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, ka qenë i përdorur jo në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, duke u mbështetur në shpjegimet e subjektit përcjellë me prapësime, por edhe në deklarin e tij në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i kaloi barra e provës se duket se kjo banesë është përdorur prej tij dhe bashkëshortes, por nuk është deklaruar prej subjektit gjatë procesit të rivlerësimit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**35.4** Subjekti shpjegon, siç ka deklaruar edhe më parë, se ky apartament ka qenë në pronësi të prindërve të tij, të cilët e kanë përdorur sa herë që kanë pasur nevojë për të qëndruar në Tiranë. Ai shpjegoi se qëndrimi në ditë të caktuara në apartamentin me adresë lagjja “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*”, është deklaruar si nga bashkëshortja e tij gjatë procesit të saj të rivlerësimit, po ashtu është sqaruar edhe nga ai vetë përpara Komisionit në shpjegimet e datës 21.3.2024, si dhe gjatë seancës dëgjimore të datës 27.3.2024. Gjatë periudhës nga muaji shkurt 2013 deri në muajin gusht 2018, kur është shitur apartamenti, subjekti shpjegon se bashkëshortja e tij ka qenë e punësuar në rrethin e Përmetit, ndërsa ai në Tiranë. Për arsye se nuk kanë pasur një banesë të tyre në qytetin e Tiranës, në pritje të një transferimi të mundshëm të bashkëshortes në një gjykatë sa më të afërt, ata vendosën të jetojnë në banesën e prindërve të subjektit, të ndodhur në Durrës, me adresë Lagjja Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, ku me lindjen e djalit u bë e domosdoshme jetesa në Durrës jo vetëm për shkak të hapësirës, por edhe për shkak të ushtrimit të detyrës së bashkëshortes në qytetin e Përmetit.

**35.5** Konsumi i luhatshtëm i energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm, i cili ka rezultuar nga hetimi shtesë, ka ardhur pikërisht për shkak të faktit se apartamenti është përdorur në ditë të caktuara nga ai dhe bashkëshortja, si dhe nga anëtarët e familjes së tij të origjinës.

**35.6** Për sa i takon faktit se kjo banesë nuk është deklaruar nga ana e tij gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti sqaron se në pyetësin standard ai i është përgjigjur pyetjes: *“Në cilat adresa keni banuar që nga momenti që keni marrë detyrën për herë të parë? Për secilën prej tyre përcaktoni kush ka qenë pronari i objektit, a keni paguar qira dhe, nëse po, kujt ia keni paguar. Paraqisni dokumentacion provues”* sipas mënyrës se si ai e ka kuptuar pyetjen dhe në asnjë moment nuk ka pasur për qëllim që të mos e deklarojë atë gjatë procesit të rivlerësimit. Sipas subjektit, në përgjigje të kësaj pyetjeje, ai ka mbajtur në konsideratë konceptin juridiko-

<sup>36</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2024.

civil, referuar terminologjisë së përdorur në nenet 12 dhe 14 të Kodit Civil në lidhje me termat “banim” dhe “banesë”, dhe nenin 14 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”. Nisur nga këto parashikime ligjore, subjekti shprehet se ka krijuar bindjen se në përgjigje të pyetjes në pyetësonin standard duhet të deklaronte vetëm adresën e banimit ku ka qëndruar në mënyrë të përhershme dhe jo adresat e apartamenteve në pronësi të nënës së bashkëshortes apo të prindërve të tij, ku ai ka qëndruar me ditë të caktuara, të cilat sipas konceptimit të tij nuk mund të konsiderohen si adresa banimi apo qëndrimi.

**35.7** Mosdeklarimi i adresës së apartamentit, lagjja “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*”, pallati i firmës “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, në përgjigje të pyetjes nr. 1 të formularit standard, sipas subjektit është një pasaktësi (për shkak të mënyrës se si është kuptuar pyetja nga ana e tij) dhe nuk ka asnjë qëllim tjetër, pasi bëhet fjalë për një pasuri në pronësi të prindërve të tij, e cila është deklaruar dhe hetuar gjerësisht gjatë procesit të rivlerësimit të bashkëshortes së tij.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**35.8** Në përfundim, Komisioni çmon se rezulton e provuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është deklaruar si adresë banimi e, për pasojë, as e drejta e përdorimit të apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*”, pallati i firmës “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*. Pasaktësia në deklaratën *Vetting* lidhur me adresën e banimit dhe përdorimin e kësaj pasurie është e vetmja gjetje e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

### **Analiza financiare (2015 – 2016)**

**36.** Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, në deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

**36.1** Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën qershor 2015 –2016, e cila rezulton me burime të ligjshme për këtë periudhë.

### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

**37.** Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë si vijon:

- Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur në pronësi, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të saj.
- Mungesa e deklarimit të adresës së banimit të një apartamenti të përdorur prej tij e bashkëshortes, si e vetmja gjetje në kuadër të vlerësimit të pasurisë së subjektit, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.

- Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**38.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

**39.** Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar në Komision raportin<sup>37</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu, ku ka konstatuar se: (i) Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) Subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**40.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**41.** Gjatë hetimit administrativ, me kërkesë të Komisionit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2023, është kërkuar pranë AKSIK-së rishikimi/përditësimi i raportit, si dhe deklasifikimi i tyre nëse ka informacione të reja për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu. Në përgjigje të saj, AKSIK-ja me shkresë konfidenciale ka informuar se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për këtë subjekt nga data 30.10.2017 dhe aktualisht.

### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të figurës**

**42.** Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**43.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja; (b) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 165 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (c) dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

**43.1** Procesi i rivlerësimit kalimtar të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative parashikohet dhe rregullohet nga neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar

<sup>37</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2023, të KDZH-së.



të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga neni 165 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**43.2** Në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; b) rezultatet e testimi pranë Shkollës së Magjistraturës”.*

**43.3** Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative është kryer në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të sipërcituar, si dhe bazuar në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar më vonë.

**43.4** Ndihmësi ligjor është njësi ndihmëse, pjesë e organizimit të brendshëm të gjykatave administrative. Në nenin 6, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përcaktohet se: *“Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor”.*

**43.5** Në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, detajohen detyrat e ndihmësit ligjor, ku shprehimisht thuhet: *“Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërtime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”.*

#### **Lidhur me kriterin e parë vlerësues – relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura**

**44.** Nga 3 dokumentet e depozituara nga subjekti dhe 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short, nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu në cilësinë e ndihmësit ligjor. Relacioni nga pikëpamja formale rezultoi të jetë përgatitur dhe përpiluar në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012.

#### **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE**

**45.** Për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit, për shkak se ndihmësit ligjorë ishin njësi e brendshme, e organizuar dhe vareshin nga gjykatat administrative. Për rrjedhojë, të dhënat profesionale dhe etike të tyre i disponojnë gjykatat përkatëse, ku ata kanë ushtruar detyrën si ndihmës ligjorë

**45.1** Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk rezultuan materiale hetimore ndaj subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu.

**45.2** Nga drejtoria e koordinimit institucional, si dhe sektori protokoll – arkiva në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, bëhet me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën viti 2006 – 2021 rezultoi se nuk ka ankesa.

## **ANALIZA E GJETJEVE**

**46.** Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga burimet e informacionit:

- i) formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti;
- ii) 3 dokumentet e depozituara nga subjekti;
- iii) 5 dokumentet ligjore të vëzhguara, të përzgjedhura me short;
- iv) të dhënat nga burimet arkivore.

### **46.1 Aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu rezulton se manifeston njohuritë e duhura ligjore për të prezantuar saktë çështjen objekt gjykimi, rrethanat e çështjes, pretendimet dhe prapësimet e palëve të parashtruara gjatë gjykimit në shkallën e parë, disponimin e shkallës së parë të gjykimit, por edhe arsyetimin e hollësishëm të saj për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Ai parashtron hollësisht shkaqet, argumentet ligjore të ankimit ndaj vendimit të shkallës së parë, duke e lehtësuar zgjidhjen e çështjes për gjyqtarin relator dhe anëtarët e trupit gjykues të cilët ka asistuar.

### **46.2 Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu rezulton se ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nga data e emërimit të saj 5.6.2015 e në vazhdim.

Në funksionin e ndihmësit ligjor pranë kësaj gjykate, ai ka deklaruar se në periudhën 9.6.2015 – 8.10.2016 ka përpiluar 1898 draft-relacione. Këto të dhëna statistikore janë pasqyruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në formularin e vetëvlerësimit profesional.

Ndërsa, sipas informacionit zyrtar të paraqitur nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, për efekt të organizmit të përzgjedhjes së 5 çështjeve me short rezulton se për periudhën 9.6.2015 – 8.10.2016 subjekti i rivlerësimit ka asistuar gjyqtaren R.S në përgatitjen, përpunimin e 377 çështjeve (relacioneve apo projektvendimeve).

Duhet evidentuar fakti se për subjektin e rivlerësimit nuk ka të dhëna direkte për ngarkesën dhe punën e tij, por të dhënat janë nxjerrë nga dosjet gjyqësore të gjyqtarit pranë të cilit ai është caktuar të asistojë.

Kuadri ligjor në fuqi për kohën kur kryhet ky vlerësim profesional, nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës Administrative të Apelit. Puna e ndihmësit ligjor është e lidhur direkt me veprimtarinë e gjyqtarit që ai asiston.

Nga të dhënat statistikore të deklaruara nga vetë ndihmësi ligjor Ervin Aliu, por edhe ato të dhëna të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë për efekt të shortit, mund të themi se subjekti i rivlerësimit ka përfunduar në kohë detyrat e ngarkuara nga gjyqtari të cilit i ka asistuar.

### **46.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2023, nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të z. Ervin Aliu, për periudhën gjatë së cilës ai ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë asaj gjykate (5.6.2015

– 8.10.2016). Gjithashtu, nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për shkelje discipline.

#### *b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu, nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, por edhe nga dokumentet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna negative në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *c) Paanësia*

Ky element vlerësues është për gjyqtarin i cili ka detyrimin ligjor jo vetëm të jetë i paanshëm në një proces gjyqësor, por edhe të sillet si i tillë sipas parimit “Drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe duhet të duket se po jepet”.

Ndihmësi ligjor nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk është pjesëmarrës në një proces gjyqësor dhe as subjekt procedural. Ndihmësi ligjor nuk është organ vendimmarrës, por këshillues, asistues i gjyqtarit. Në tërë relacionet e përgatitura nga ndihmësi ligjor Ervin Aliu nuk konstatohen elemente favorizuese apo njëanshmërie në raport me palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në ato procese gjyqësore që u korrespondojnë atyre relacioneve.

### **46.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

Në aktet ligjore të vëzhguara nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës ndihmësi ligjor nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në aktet e përpiluara prej tij mund të vlerësohet si korrekte dhe normale.

Në lidhje me aftësitë e ndihmësit ligjor Ervin Aliu në komunikim me gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit, drejtuesin e gjykatës apo edhe me pjesëtarë të stafit administrativ të asaj gjykate nuk janë evidentuar probleme.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 relacionet e vëzhguara, nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë, në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse të trajtuara gjatë këtij procesi rivlerësimi nuk është evidentuar ndonjë problematikë në bashkëveprimin e tij me gjyqtaren që ka asistuar.

#### *c) Gatishmëria për t’u angazhuar*

Referuar dokumentacionit të dosjes, rezultoi se subjekti Ervin Aliu është diplomuar Jurist në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës, pasi përfundoi studimet në periudhën 1996 – 2000.

Pas një eksperience trivjeçare si sekretar gjyqësor, por edhe pas një përvoje të pasur si jurist pranë institucioneve shtetërore, subjekti i rivlerësimit në datën 5.6.2015 është emëruar si ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Subjekti Ervin Aliu ka marrë edhe titullin “Avokat” nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në datën 31.5.2003.

Referuar formularit të vetëvlerësimit, por edhe dokumentacionit që ai ka sjellë, rezultoi se ai ka kryer marrë pjesë dhe është certifikuar në katër trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe në dymbëdhjetë trajnime të organizuara nga institucione të tjera vendase apo ndërkombëtare. Rezultoi se temat e këtyre trajnimeve kanë lidhje të rëndësishme me detyrën që ai ushtron si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, pasi çështjet e trajtuara janë në kompetencë gjykimi të gjykatave administrative.

Është autor i dy shkrimeve në revistën juridike “T j”, ku ka shkruar artikujt “Shpallja e personit si i zhdukur dhe i vdekur”, shkrim i botuar në vitin 2003 dhe “E drejta penale në fjalimet e Ciceronit”, shkrim i botuar në vitin 2005.

### **Lidhur me kriterin e dytë vlerësues, rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës**

**47.** Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018, ka vendosur në dispozicion të Komisionit rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuara në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**47.1** Nga verifikimi i tabelave të rezultateve u konstatua se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale “Testi elektronik”, subjekti është vlerësuar me 121 pikë, nga 200 pikë të mundshme, duke mos u përzgjedhur për të ndjekur formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në bazë të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **GJETJE TË TJERA**

**48.** Nga hetimi rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka qenë me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës nga muaji qershor 2018.

**48.1** Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit lidhur me faktin nëse ai ka trajtuar si ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit ankime mbi vendime të marra nga ana e bashkëshortes së tij, znj. R.A (P), gjatë ushtrimit të detyrës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

**48.2** Nga hetimi rezultoi<sup>38</sup> se për çështjen nr. \*\*\* regj. themeltar, datë 18.11.2019, me palë paditëse F.B e gjyqtarit S.I, gjykuar në vitin 2023, kishte dhënë vendimin në shkallë të parë bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. R.A (P).

**48.3** Sa më sipër, duket se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Në këto kushte, subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me këtë konstatim të Komisionit.

**48.4** Në shpjegimet e datës 21.3.2024, në lidhje me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu ka shpjeguar se gjyqtari S.I e ka vënë në dijeni se relacioni dhe aktet e tjera procedurale të çështjes nr. \*\*\* regj. themeltar, datë 18.11.2019, në bazë të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, janë bërë nga ana e tij, i cili kryesisht ka vlerësuar të shmangë në këtë mënyrë konfliktin e interesit, pasi ka qenë në dijeni të faktit se R.A (P), gjyqtarja që kishte marrë në shqyrtim dhe kishte dhënë vendimin në shkallë të parë, është bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Më tej, në shpjegimet e tij subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu bën me dije

<sup>38</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2024, e Gjykatës Administrative të Apelit.

Komisionin se në datën 20.12.2022 ai ka paraqitur kërkesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për transferim në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për shkak të papajtueshmërisë ambientale, sepse bashkëshortja e tij ishte në proces për ngritjen në detyrë si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit. Në lidhje me këtë kërkesë deklaroi se ka vënë në dijeni gjyqtarin S.I, pranë të cilit ushtronte detyrën sipas urdhrit nr. \*\*\*, datë 15.7.2022 “Për caktimin e ndihmësit ligjor pranë gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, z. S.I”. Më tej, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur transferimi i tij në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë. Referuar kohëzgjatjes së gjykimit dhe datës së dhënies së vendimit nr. \*\*\*, datë 28.9.2023, subjekti deklaroi se gjatë kësaj kohe nuk ka qenë ndihmës ligjor i gjyqtarit S.I, pasi me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur transferimi i tij në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke ushtruar detyrën në vijim pranë kësaj të fundit dhe jo më në Gjykatën Administrative të Apelit<sup>39</sup>.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**49.** Në përfundim të hetimit, trupi gjykues çmon se për rastin nuk jemi në kushtet e konfliktit të interesit, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e studimit të dosjes apo pjesë e prodhimit të akteve të tjera administrative gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësit ligjor pranë gjyqtarit S.I në kohën e gjykimit të këtij rasti në Gjykatën e Apelit.

### **DENONCIME**

**50.** Nga verifikimi i regjistrit të denoncimeve nuk rezulton që të jenë depozituar në Komision ankesa apo denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu, në kuptim të nenit 53 të ligjit 84 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

**51.** Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nga Komisioni nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon kriterin profesional të ndihmësit ligjor Ervin Aliu dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektiv dhe eficient në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “i aftë”.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

<sup>39</sup> Shkresë “Kthim përgjigje” nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2024, e Gjykatës Administrative të Apelit, së cilës i bashkëlidhet shkresa “Kthim përgjigje” drejtuar zv. kryetarit A.D nga gjyqtari S.I; Kërkesë datë 20.12.2022, drejtuar nga unë Ervin Aliu Këshillit të Lartë Gjyqësor për transferim në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për shkak të papajtueshmërisë ambientale, sepse bashkëshortja ime R.A (P) ishte në proces për ngritjen në detyrë si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit; Vendimi nr. \*\*\*, datë 16.2.2023, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, me të cilin është vendosur transferimi im në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bashkëlidhur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2023 “Njoftim vendimi”; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2024, lëshuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 22.5.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
**Kryesuese**

**Alma FASKAJ**  
**Relatore**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare (kundër)**

*Sekretare gjyqësore*  
*Albana Plaka*